



Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian



## Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje për Zhvillimin e Zgjidhjeve Alternative të Mosmarrëveshjeve në Shqipëri”

### Vështrim i Përgjithshëm

Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje për Zhvillimin e Zgjidhjeve Alternative të Mosmarrëveshjeve në Shqipëri” financuar nga BE, filloi në Tetor 2015 dhe zgjat deri në Prill 2017. Projekti zbatohet midis Ministrisë së Drejtësisë, Institutit Kombëtar për Shëndet dhe Mirëqenie në Finlandë në partneritet me Institutin Çek të Shërbimit të Provës dhe Ndërmjetësimit. Përfituesit e këtij Projekti janë Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit në Shqipëri.

Gjatë 18 muajve të zbatimit të tij Projekti do të ofrojë ekspertizën Finlandeze dhe Çeke në Shqipëri. Ekspertët do të bashkëpunojnë me përfaqësues të vendit përftues në aktivitete të ndryshme kryesisht në fushën e Ndërmjetësimit. Objektivi i përgjithshëm është rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së Zgjidhjeve Alternative të Mosmarrëveshjeve dhe mbështetje për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve të ndërmjetësimit dhe arbitrazhit në Shqipëri.

### Aktivitetet e Projektit

Përfundimet e projektit që lidhen me rezultatet e pritshme do të zbatohen nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të tilla si familjarizimi me situatën aktuale, analiza, takime, seminare, tryeza të rumbullakëta, trajnime dhe vizita studimi në Shtetet Anëtare të BE-së.

### Komponentët e Projektit

Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje për Zhvillimin e Zgjidhjeve Alternative të Mosmarrëveshjeve” është i organizuar në katër komponentë kryesorë si më poshtë:

#### 1. Konsolidimi i Kornizës Ligjore

Qëllimi kryesor i këtij komponenti është të analizojë dhe identifikojë boshllëqet në kornizën ligjore dhe ta harmonizojë atë me standardet Evropiane për të mundësuar aksesin në drejtësi dhe promovuar përdorimin e ndërmjetësimit si zgjidhje alternative. Harmonizimi i Ligjit për Ndërmjetësimin me ligje të tjera, të tilla si Kodi i Familjes, Kodi i Procedurave Civile dhe Penale, për të lehtësuar referimin e çështjeve tek ndërmjetësimi nga gjyqtarët dhe prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, veçanërisht rastet që përfshijnë të rinjtë në konflikt me ligjin dhe gjithashtu të mundësojnë palët të shkojnë vetë tek ndërmjetësimi pa u adresuar tek gjykatat.



Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian



## **2. Forcimi i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit**

Aktivitetet e këtij komponenti kanë për qëllim konsolidimin e strategjisë së Dhomës së Ndërmjetësimit, zhvillimin e dokumenteve të standardizuara të punës për shërbimin, një manual për Ndërmjetësit dhe fuqizimin e monitorimit, inspektimit dhe kapaciteteve të kontrollit të Dhomës. Një nga prioritetet e palës përfituese është zhvillimi i kapaciteteve të trajnimit, trajnimi për trajnerët dhe zhvillimi i kurrikulave për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm për të gjithë ndërmjetësit.

## **3. Rritja e ndërgjegjësimit për ndërmjetësimin dhe Bashkëpunimin Ndër-Institucional**

Aktivitetet këtij komponenti kanë për qëllim fuqizimin e aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe projektimit të fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit. Qytetarëve, palëve të interesuara dhe aktorëve të tjerë duhet ti ofrohet njohuria për disa mundësi si dhe për ndërmjetësimin si një alternativë e mirë dhe më pak e kushtueshme për njerëzit për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre.

Objektivi tjetër i këtij komponenti është përmirësimi i bashkëpunimit ndër-institucional, procedurave dhe mekanizmave të referimit.

## **4. Arbitrazhi**

Projekti ka një Komponent tjetër për Arbitrazhin. Zbatimi i këtij komponenti duhet të specifikohet më vonë.

Ceremonia e hapjes së projektit u krye në 12 Nëntor ( njoftimi për shtyp bashkëngjitur). Misioni i parë mbi analizën e kornizës ligjore u bë në 23 – 27 Nëntor 2015.